




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-2608/14</u>
Nr. I faq. Broj stranica <u>03</u>	Data Datum <u>11-07-2014</u>
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	11.07.2014
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.K.
PËR/ZA/TO:	z. Jeton Gashi – Shef i Prokurimit – Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni – Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion - Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari ztr. Gashi

Lidhur me kërkesën tuaj të pranuar në Agjencinë kundër Korrupsionit (DPK-03-1994/14), ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; "bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave", si dhe ofron opinione dhe ndërmerr të gjitha masat tjera ligjore me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit dhe të korrupsionit në tërësi. (Neni 19, pika 1.5, dhe 1.6 të Ligjit Nr.04/L-051).

Andaj bazuar në pyetjen tuaj, se a paraqet konflikt interesi që Kryetari i Odës Veterinare të Kosovës të ketë kompani private të veten, dhe nëse oferton për shërbime veterinarë dhe ofron çmim me të ulët, dhe fiton tenderin për shërbimet e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, kur dihet se ai pranon një pagë nga Buxheti i Odës Veterinare të Kosovës, ku një pjesë e tyre është nga derdhja e mjeteve nga AUV, sipas memorandumit të datës 18.10.2013 dhe të nënshkruar nga këto dy subjekte kemi nxjerrë këtë:

OPINION :

Ekziston konflikt i mundshëm i interesit në nënshkrimin e kontratës për shërbime të Veterinarisë në mes të Kryetarit të Odës Veterinare të Kosovës, si përfaqësues i kompanisë konkurrese për shërbime veterinarë me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, pasi që këto dy subjekte (Odës Veterinare të Kosovës dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës) kanë të nënshkruar memorandum bashkëpunimi në mes veti për realizimin e të hyrave prej 5% të mjeteve ku AUV i jep Odës Veterinare të Kosovës konform memorandumit të cekur më lartë, ku nga kjo shumë përfiton edhe vet kryetari i Odës Veterinare të Kosovës.

Kjo çështje lidhet edhe me etikën, pasi që ndikojnë në besimin dhe pritjen e qytetarëve në zbatim të mirëfilltë të ligjit dhe luftim të Korrupsionit.

Ju si Shef i Prokurimit duhet të respektoni se pari Kodin Etik të Prokurimit ku thotë : Zyrtarët e prokurimit do të sillen në çdo kohë në pajtim me përgjegjësitë e postit të tyre dhe do të kenë kujdes të veçantë se sjellja e tyre nuk do të ketë efekt të dëmshëm për organizatën e tyre, që rrjedh nga konflikti mes interesave të tyre dhe interesave të organizatës.

Ndërsa ju në cilësi të zyrtarit të lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik si dhe zyrtaret tjerë që ushtrojnë funksionin e zyrtarit të lartë në institucionin tuaj duhet të keni të qartë se neni 7.8 e Ligjit Nr.04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik parasheh se :

Zyrtarët e lartë nuk duhet që të lejojnë që interesat e tyre private të bien në konflikt me funksionet e tyre. Ata duhet të shmangin konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real (faktik) apo i mundshëm.

Këtu do tu njoftojmë cilat situata konsiderohen konflikt interesi për zyrtarin e lartë në ushtrim të funksionit Publik.

Së pari është me rëndësi të citojmë nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i cili përkufizon **çka është konflikti i interesit ?**.

Nga ky përkufizim kuptojmë, pos të tjerash, se; *“konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”*.



Po ashtu në Nenin 8 të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit janë të përcaktuara detyrimet e zyrtarit të lartë për të shmangur situatat e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërsa neni 13 I këtij Ligj ka parapa Deklarimin rast për rast të interesave private të zyrtarit të lartë ku ndër të tjera thotë si vijon:

1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimarrje për ndonjë çështje të caktuar.

Konfliktit të Interesit është e paraparë si vepër Penale edhe në Nenin 424 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prandaj duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, ju rekomandojmë që të veproni konform këtij Opinioni të bazuar në Ligjin përkatës, për të parandaluar dhe shmangur çdo situatë që mund të sjellë në gjendje të konfliktit të interesit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Me respekt,